



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:288960
Datë: 11.10.2024
Numri i dokumentit: 06364382

KF.nr.17/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “Pozhegu Brothers” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811251032, dhe me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Granit Vokshi, avokat nga Shoqëria e Avokatëve “Koci & Vokshi”, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 57,680.00€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Granit Vokshi avokat, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 25.09.2024, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Pozhegu Brothers” Sh.P.K, me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET pjesërisht vendimi nr.358/2019 i datës 11.11.2019 i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, vetëm sa i përket zvogëlimit të KMSH-së dhe mosnjohjes së shpenzimeve operative për vitin 2014.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, “Pozhegu Brothers” Sh.P.K, me seli në Prishtinë të ia kthej shumën prej 18,523.74 euro si rezultat i zvogëlimit të KMSH-së reale dhe shumën prej 39,156.29 euro si rezultat i mosnjohjes së shpenzimeve operative të vitit 2014, gjithsej në shumë prej 57,680.00 euro (pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqindën e tetëdhjetë euro), me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerr nga e paditura e deri në pagesën definitive.
- IV. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e vendimit nr.358/2019 i datës 11.11.2019 të Departamentit të Ankesave të ATK-së, sa i përket vlerësimeve tjera tatimore.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 11.12.2019, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.358/2019 i datës 11.11.2019, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia, të anulohet vendimi i kundërshtuar, dhe të detyrohet e paditura që t'i paguaj shpenzimet procedurale. Në seancën e shqyrtimi gjyqësor kryesor përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se ne e kemi pranuar plotësimin e ekspertizës financiare dhe me të njëjtën pajtohemi në plotëni dhe nuk kemi ndonjë pyetje sqaruese për ekspertin ngase konsiderojmë se mendimi dhe konstatimi është i qartë për gjykatën. Ndërsa në parashtresën për precizimin e kërkesëpadiisë të dorëzuar në këtë seancë kanë kërkuar që të aprovohet në tërësi si e themeltë padia, të anulohet vendimi kontestues dhe të obligohet e paditura që paditësi t'ia kthej shumën e përgjithshme prej 57,680.00 euro, edhe atë shumën prej 18, 523.74 euro si rezultat i zvogëlimit të KMSH-së reale dhe shumën prej 39,156.29 euro si rezultat i mosnjohjes së shpenzimeve operative për vitin 2014 të gjitha këto me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerr nga e paditura deri në pagesën definitive. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë ashtu siç është precizuar në seancën e sotme. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë, është kundërthënës në vetvete në arsyetimin e tij. Ky aktvendim është marrë me shkeljet të dispozitave përkatëse procedurale ligjore respektivisht në kundërshtim me par. 1 nën paragrafin 2.2 të nenit 5 të Ligjit për Tatim dhe të Ardhura të Korporatave e po ashtu në kundërshtim me par.4 pika 4.1, 4.2.5 të UA nr. 02/16 të ligjit 05/L-029 si dhe në kundërshtim të plotë me vendimin shpjegues publik 01/2014 mbi të ardhurat e tatueshme nga ndërtimi afatgjatë. Dy pikat kryesore kontestuese në këtë vendim si llogaritja e gabuar e etazhitetit tek projekti Bregu i Diellit si dhe mos pranimi i shpenzimeve të kostove indirekte për projektet në vijim për vitin 2014 janë konfirmuar edhe nga ekspertiza financiare për të cilën kërkojmë që ti falet besimi. Andaj marrë parasysh faktin se në padi dhe në seancën përgatitore kemi dhënë argumente shteruese rreth paligjshmërisë të vendimit kontestues, ne mbesim në tërësi pranë të njëjtave argumente duke kërkuar nga gjykata që të aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar.

E paditura në përgjigje në padinë të datës 11.01.2021, konstaton se vendimi i DA nr.358/2019 i datës 11.11.2019 është i bazuar në dispozitat e legjislacionit tatimor dhe konteston padinë e

paditësit si të pa bazuar. Tutja ka theksuar se lidhur me pikën e parë kontestuese për mos marrje për bazë e deklaratës së lartave korigjuese për CD-2009, ATK-ja gjatë vlerësimit nga ana e kontrolli ka konstatuar se deklarata e lart cekur është proceduara nga ana e ATK-së në raportin e ri sqarues të datës 18.10.2019 ku është pranuar si KMSH shpenzim direk dhe kjo humbje është bartur në periudhën 2010, ku kjo periudhë 2010 ka qenë e proceduar gabimisht me humbjen e bartur, ku ky gabim është korigjuar nga DA në deklaratën MFA2H5000871323D duke marr për bazë pagesën e tërësisht për periudhën në vlerë prej 12,402.75 euro. Pika tjetër kontestuese është edhe ngarkesa e shitjeve shtesë për vitin 2014 nga të ardhurat e llogarive të arkëtueshme FK, BD, mos deklarimi i objektit të Mati 1 1-2009 dhe mungesa në stoqe në Mati 1 emërtimi llogari të arkëtueshme me kontrolle është njohur në bazë të inkasimit, e në momentin e hyrjes së banorëve në objekt mjete e pa inkasuara trajtohen si të hyra në atë periudhë. Por pas verifikimi të pagesave në librin kryesor të shitjes vërehet që këto pagesa janë brenda periudhës 2009-2014 dhe për projektin FK nuk do të kemi të hyra shtesë nga LL/A në vitin 2014 i cili ndryshim do të reflektoj tek pasqyra e të ardhurave në vitin 2014. Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditur e ka pranuar ftesën për këtë seancë, ndërsa me parashtesën e datës 23.09.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veprojnë në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së. Po ashtu me këtë parashtesë e ka njoftuar gjykatën se kundërshton plotësimin e ekspertizës të datës 18.09.2024 të ekspertit L.M. dhe mbasin pran kundërshtimit të ekspertizës së datës 01.07.2024. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padi/ankesa e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.358/2019 i datës 11.11.2019.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 25.09.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi nr.358/2019 datës 11.11.2019, Ankesë e datës 05.08.2019, Deklarata e tatimit në të ardhura të korporatave periudha 2009, Pasqyrë e përmbledhur e të ardhurave për qëllime tatimore, Pasqyra e të ardhurave 01.12.2014, Pasqyra e bilancit 31.12.2009, Formular i deklarimit vjetor dhe pagesës së tatimit në të ardhura të korporatave të periudha 2010, pasqyra e të ardhurave datës 02.12.2014, Formular i deklarimit vjetor dhe pagesës së tatimit në të ardhura të korporatave të periudha 2010, pasqyra e të ardhurave datës 31.12.2010, Formular i deklarimit vjetor dhe pagesës së tatimit në të ardhura të korporatave të periudha 2011, pasqyra e të ardhurave dt 31.12.2011, Transaksion bankar i datës 30.03.2012, Formular i deklarimit vjetor

dhe pagesës së tatimit në të ardhura të korporatave të periudha 2012, Fletëpagesë për CD - tatim mbi korporatat, Formular i deklarimit vjetor dhe pagesës së tatimit në të ardhura të korporatave të periudha 2013, pasqyra e të ardhurave datës 31.03.2014, Formular i deklarimit vjetor dhe pagesës së tatimit në të ardhura të korporatave të periudha 2014, pasqyra e të ardhurave datës 31.03.2015, Raport i kalkulimit të kostos çmimit kushtues për njësi: për njësinë C11/A1 Lagjja Mati 1, B14, C11/B11, C11/A4, C11-A5, objekti Lagjja e Muhaxherëve B02, Kërkesë drejtuar ATK datës 18.06.2019, Raporti i kontrollit 02.07.2019, Përgjigje në padi 11.01.2021, Vlerësimet për periudhën 2009, 2010, Detajet e vlerësimit nga ATK e datës 30.09.2019, Fletat e punës, Formular i deklarimit të pagesës për CD 2014, 2012, Sqarime shtesë lidhur me raportin e kontrollit sipas kërkesës të DA datës 18.10.2019, Njoftim ri vlerësimi dhe gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera datës 14.11.2019 dhe e datës 05.01.2021, Ekspertiza financiare dhe plotësimi i ekspertizës i datës 18.09.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka kryer kontroll tek paditësi me datë 02.07.2019, ku objekt kontrolli ka qenë CD 2013-2014. Po ashtu nuk janë kontestuese edhe faktet se paditësi pas pranimit të Njoftim Vlerësimeve me datë 05.08.2019 ka parashtruar ankesë pran Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila me datën 11.11.2019 ka marrë vendimin nr.358/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën nr.358/2019 të datës 05.08.2019 dhe ka ndryshuar Njoftim Rivlerësimin e periudhës CD 2014, ndërsa pjesën tjetër e ka lënë të pa ndryshuar dhe obligimi për tatimpaguesin e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 11.12.2019, ka iniciuar konflikt administrativ pranë gjykatës.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave, ka aprovuar pjesërisht ankesën nr.358/2019 të datës 05.08.2019 dhe ka ndryshuar Njoftim Rivlerësimin e periudhës CD 2014, ndërsa pjesën tjetër e ka lënë të pa ndryshuar dhe obligimi për tatimpaguesin, me arsyetim se lidhur me pikën 1.1 kontestuese mos marrja për bazë Deklaratën korigjuese MFA2H50041734640 të vitit 2009, sipas DA-së gjatë vlerësimit me kontroll konstatohet se deklarata e lart cekur është proceduar nga ana e ATK-së dhe me raportin e ri për shqyrtim e pranuar si KMSH e shpenzimet direkt vlera prej 77,358.49 euro dhe kjo humbje është bartur në periudhën 2010, ku faktikisht kjo periudhë 2010 ka qenë e proceduar me humbjen e bartur në vlerë prej 165,841.04 (në mënyrë manuale nga TI-ve), pra ky gabim është korigjuar nga DA në Deklaratën MFA2H5000871323D, duke e marr për bazë pagesën e tërësishme për periudhën në vlerë 12,402.75 euro. Tutja ka theksuar se sipas tatimpaguesit kalkulimi i gabuar i kostos reale si dhe etazhiteti të projektit B.D., sipas raportit të ri të shqyrtuar nga DA konstatohet sipërfaqja bruto e pasqyruar në total 5,612.59 euro dhe sipërfaqja neto për shitje 4,648.00 m², të cilat janë të ndërtuar në dy lamela (objekte). Po ashtu mos pranimit i shpenzimeve të përgjithshme në vlerë prej 391,652.93 euro nga DA vërtetohet se tatimpaguesi shpenzimet operative në vitet 2009-2014 i ka të njohura edhe si KMSH në vlerë 595,387.99 euro, me kontroll nuk është pranuar që një blerje të njihet dy here (një herë si shpenzim operativ i periudhës dhe një herë si KMSH). Shpenzimet operative prej 391.652.93 euro për periudhën CD/2014 me kontroll faktikisht nuk janë të njohura dhe pasi këto shpenzime nuk janë të njohura nuk mundet që vlera prej 595,387.99 euro të përlllogaritet si e hyrë tjetër jo operative, andaj DA shpenzimet operative pa paga dhe zhvlerësim të njohur ndërsa vite do ti njeh për vitin 2019-16,295.62 euro, 2010-36,260.18 euro, 2011-33,098.72 euro, 2012-47,535.20 euro, 2013-70,635.04 euro, dhe për periudhën CD/2014 vlera 391, 562.00, ndërsa zëri i të hyrave tjera operative mbetet i njëjtë në vlerë prej 595,387.99 euro.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.17/22 të datës 16.02.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar-administrativ me ekspertin financiar L.M., me detyra përkatëse si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga mendimi dhe konstatimi i nxjerrë i ekspertit financiar në ekspertizën financiare dhe plotësimi i ekspertizës i datës 18.09.2024 ka konstatuar se: *“Sipas detyrës së përcaktuar nga gjykata dhe duke u bazuar në llogaritë më lartë dhe dokumentet që e kemi shqyrtuar gjatë përpilimit të ekspertizës financiare kemi ardhur në përfundim që, efekti i përgjithshëm tatimor në CD për paditësin si rezultat i zvogëlimit të KSMH-së reale nga 1,320,198.82 në 1,134,961.34 paraqet një diferencë prej 185,237.48 dhe duke llogaritur normën 10% të kësaj difference, vlera e rritur për pagesë tatimi është 18,523.74 euro, efekti tatimor i mos njohjes së shpenzimeve operative në vlerë prej 391,562.93 është rritja e tatimit në vlerë direkt në CD të vitit 2014 është 39,156.29 euro”*.

Në seancën në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 25.09.2024 eksperti financiar L.M. ka deklaruar se: *“mbesim pranë plotësimi të ekspertizës financiare të datës 18.09.2024, jam i gatshëm për sqarime shtesë”*.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare dhe plotësimi i ekspertizës i datës 18.09.2024 të punuar nga eksperti financiar L.M., në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Gjykata përmes nxjerrjes së provën me ekspertizë financiare gjeti se efekti i përgjithshëm tatimor në CD për paditësin si rezultat i zvogëlimit të KSMH-së reale nga 1,320,198.82 euro në 1,134,961.34 euro paraqet një diferencë prej 185,237.48 euro dhe duke llogaritur normën 10% të kësaj difference, andaj kostoja e mallit të shitur për projektet Bregu i Diellit 1 dhe 2 është 18,523.74 euro, ndërsa pas analizimit të pasqyrave financiare CD 2014 dhe librat e blerjes për vitin 2014 konstatohet efekti tatimor i mos njohjes së shpenzimeve operative në vlerë prej 391,562.93 euro është rritja e tatimit në vlerë direkt në CD të vitit 2014 edhe atë 39,156.29 euro.

Gjykata ka shqyrtuar kundërshtimin e të paditurës të datës 03.07.2024 lidhur me ekspertizën financiare, në të cilën është konstatuar se ATK-ja ka konstatuar se paditësit për periudhën 2009-2014 i janë njohur shpenzimet operative, një pjesë si KSMH dhe pjesa tjetër të njohur edhe si investim në vijim për projektet e papërfunduara, andaj me kontroll nuk është pranuar që një

blerje të njihet dy herë. Po ashtu konstatohet se paditësi shpenzimet operative i ka të njohura si KMSH në vlerë prej 595,387.99€, prandaj një blerje nuk mund të njihet dy herë si shpenzim operativ dhe si KMSH. Lidhur më këtë pretendim gjykata konstaton se eksperti financiar ne ekspertizën financiare ka sqaruar me detaje shpenzimet operative dhe KMSH, dhe në bazë të dokumentacionit të ofruar nga paditësi ka llogaritur KMSH si dhe shpenzimet operative dhe ka ardhur në përfundim se shpenzimet operative nuk janë inkorporuar në KMSH, por te njëjtat janë trajtuar ndaras dhe se nuk janë paraqitur dy herë si kosto e mallit, nga ku ka rezultuar edhe Kostoja e Mallit të Shitur është 1,320,198.82€, ndërsa shpenzimet operative janë 391,562.93€.

Tutje, Gjykata sikurse përmes ekspertizës financiare ka vërtetuar faktin që ATK konstatimet e saj në vendimin e kontestuar nuk i mbështet në asnjë dokumentacion dhe me ndonjë fakt, por gjitha shpenzimet operative të tatimpaguesit e të cilat nuk kanë të bëjnë fare me shpenzime direkte i trajton si KMSH.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, ballafaqimit të provave në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të vendimit kontestues, gjykata vlerësoi se organi i paditur ATK-së ka nxjerr konkluzion jo të drejt në pikëpamje të gjendjes faktike edhe atë lidhur me koston e mallit të shitur KMSH për sasinë neto, respektivisht për shitjet të dy projekteve të quajtura Bregu i Diellit 1 dhe Bregu i Diellit 2, si dhe lidhur shpenzimet e përgjithshme apo kostot indirekte, prandaj Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 43, par 3 dhe 46 par. 3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit, anuloi vendimin kontestues dhe e detyroj të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Pozhegu Brothers” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të ia kthej shumën prej 18,523.74 euro si rezultat i zvogëlimit të KMSH-së reale dhe shumën prej 39,156.29 euro si rezultat i mosnjohjes së shpenzimeve operative të vitit 2014, gjithsej në shumë prej 57,680.00 (pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqindën e tetëdhjetë euro), me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerr nga e paditura e deri në pagesën definitive.

Me nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 përcaktohet se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*, ndërsa me nenin 7 par 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se barra e provës bie mbi palët ndërgjyqëse.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”*, paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”*. Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”*, paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*.

Vendimi mbi kamatë në shumën e obliguar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke aplikuar e dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*.

Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Kjo për faktin se paditësi pretendimet e veta siç u vlerësuar edhe më lartë i ka të bazuara në fakte, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për tu njohur si të tilla.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.17/22 datë 25.09.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.